

REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IX-TË ME RADHË E -V- E RREGULLT E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 30 KORRIK 2020

Mbledhja është mbajtur në objektin e Shkollës së Mesme Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri, duke filluar në orën 10:00.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Hysni Gërguri, Gentiana Rama, Miljan Bojković, Shpëtim Zhegrova dhe Shkëlzen Feka.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 30 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi të mbahet një minutë heshtje në nderim të viktimave nga pandemia Covid-19 në Komunën e Vushtrrisë.

Në vazhdim anëtarët e kuvendit nderuan me një minutë heshtje të gjitha viktimat e rëna nga pandemia covid-19 në Komunën e Vushtrrisë.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-adrosi kërkesën në Drejtorinë e Financave që personat me nevoja të veçanta (të verbrit) të lirohen nga taksat dhe tatimet e drejtpërdrejta, kjo është e domosdoshme dhe tepër e nevojshme kur kemi për bazë gjendje e rënduar të kësaj kategoria nga pandemia covid-19. Ndërsa kërkesën tjetër e adresoi për Drejtorinë e Shërbimeve Publike për zgjerimin e kyçjes së rrugës "Shote Galica" në rrugën magjistrale, pasi aty po rrezikohet jeta e qytetarëve gjatë kyçjes në rrugën kryesore magjistrale.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-duke ju referuar pikës së nëntë të rendit të ditës, lidhur me ofrimin e ndihmës financiare për shoqatën “Down Sindrom Kosova” dega në Mitrovicë, njoftoi se nga takim që kanë pasur me këtë shoqatë grupi i grave anëtare të kuvendi, ka nxjerrë konkluzionin se kjo shoqatë po ballafaqohet me kushte të rënda financiare dhe kështu po rrezikohet procesi i ofrimit të shërbimeve për personat që vuajnë nga sindromi “Down”. Andaj duke marr për bazë opinion ligjor të zyrës ligjore, propozoi që kjo pikë të largohet nga rendin i ditës, dhe kërkoi nga shoqata e sipërcekur që të aplikoj sipas thirrjes publik për subvencionin e OJQ-ve konfrom legjislacionit në fuqi.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-adresi shqetësimin e tij dhe të gjithë qytetarëve të Vushtrrisë që Spitali i Vushtrrisë të shndërrohet në spital-covid, dhe në këtë rast duke marr për bazë kryeneçësinë e ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë i cili nuk ka pyetur fare Komunën e Vushtrrisë për një gjë të tillë, andaj duke e bazuar në kundërshtimet e grupit kuvendar të PDK-së, LVV-së dhe kryetarit të komunës kërkoi që Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë të nxjerr një deklaratë që e kundërshton vendimin që spitali jonë të shndërrohet në spital për trajtimin e virusit covid-19.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-pasi shprehu ngushëllime për të gjitha viktimat nga pandemia covid-19 në Komunën e Vushtrrisë, apeloj të gjithë qytetarët që të kenë kujdes jashtëzakonisht të madh edhe gjatë vizitave në institucionet shëndetësore pasi gjendja në spitalin e Vushtrrisë ku është shndërruar në një klinik infektive është delikate dhe e brishtë, andaj qytetaret duhet ti respektojnë masat e IKSHPK-së duke bartur maskat dhe distancën sociale. Ajo tërhiqi vëmendjen që kujdesi të rritet pasi sistemi shëndetësor është i brishtë dhe praktikisht gjendet pranë kolapsit e që në një gjendje të tillë situata epidemiologjike do të rëndohet dhe kësisoj do të mund të rritet edhe numri i humbjes së jetëve.

Fitim Halili, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendit drejtoj kritika të ashpra ndaj kryetarit të komunës ku ceku se: me të ardhur në pushtet kryetari i komunës filloj me lojërat e tij për mbrojtjen e rrejshme të objektit të shtëpisë së kulturës, pastaj duke premtuar për sigurimin e ujit të pijes për të gjitha vendbanimet e Komunës së Vushtrrisë brenda afatit prej 12 muajve. Publikisht patë gënjyer kur premtonte se në përbërjen e qeverisë së tij do ti emëronte së paku pesë drejtoresha. Ky njeri erdhi në pushtet sepse i mashtrroj qytetarët, ku ditët e para të pushtetit i filloj me punësimin e vëllait të tij, duke vazhduar me akomodimin e vjehrrit të tij në pozitën e kryeshefit të administratës në QKMF. Pastaj kryetari i komunës nuk u ndal me kaq duke vazhduar me kontrata mbi vepër për ti akomoduar militantët e LVV-së, AKR-së dhe Nismës Social Demokrate, për faktin se ju kishte premtuar dhe ata i rrinin mbi kokë. Pastaj i hyri pazarit me asamblistët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë ku një anëtare e kuvendit nga radhët e PDK-së ju punësuan anëtarët e familjes, dhe e njëjta u largua nga grupi kuvendar i PDK-së duke u deklaruar si e pavarur vetë për interesa të tyre. Një anëtare tjetër nga radhët e AKR-së i’u rehatuan vëllain në pozitën e zëvendës drejtorit në një shkollë të Komunës së Vushtrrisë, dhe e njëjta ju bashkua grupit kuvendar të LDK-së. Pastaj i punësojë dy anëtare të kuvendit njëra nga radhët e AKR-së e tjetra nga radhët e LB-së por është interesant se përse këtu dy anëtare nuk i futi në radhët e grupit kuvendar të LDK-së për faktin se këto dy anëtare të kuvendit votojnë symbyllur në kuvend dihet në favorin tuaj. Kur filluan qarjet mes juve dhe LVV-së, shumë shpejt u angazhuar në rehatimin e familjarëve të drejtorëve, i avancuat në grada disa shërbyes civil të preferuar për faktin se pritej të fuqizohej ligji për pagat etj. Ky kryetar komune duke parë se gënjeshttrat janë duke ju shitur premtonte investime prej 5 milion euro në minierën e Dubocit e cila është nga minierat më të vjetra dhe në të do të filloj të investoj një kompani polake, kjo gjë kurrë nuk u bë realitet. Mandej 100 milionë euro investime për energji të ripërtitshme në Vushtrri. E mbani mend kur thoshte 200.000.00 € investime për

largimin e kablllove nga sheshi i qytetit të Vushtrrisë ku punimet do të nisnin në tetor këtë e thoshte para dy viteve. Pastaj Vushtrria me model të Tiranës për ndërtimin e tregut, Vushtrria me stacion të ri të autobusëve, pat premtuar se janë ndarë 20.000.00 € për studimin e fizibilitetit për pronën e ish Hotelit Vicanum në të cilën planifikohet të ndërtohet stacioni i autobusëve, pse mendon se mund të ndërtoni në tokë të huaj. Tutej ishte premtim i po këtij kryetari, ndërtimi i fabrikës për përpunimin e peshkut ku do të punësoheshin 200 punëtor kryesisht gra, për këtë edhe pse kishim dyshimet tona në anëtarët e kuvendi pa dallim partie e votuam në mënyrë unanime këtë projekt dhe për dhënien e pronës në shfrytëzim për këtë destinimin dhe për negociimin e kësaj kontrate, por çfarë ndodhi me këtë projekt i cili nuk realizua kurrë, dhe kryetari i komunës nuk mori mësim nga dështime kurrë ashtu që vazhdoi prapë me avazin e vjetër.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se qeveritë e kaluara nuk kanë menduar shumë për shëndetësinë e vendit, dhe tani jemi ku jemi me një gjendje të rënd në këtë lami duke ja shtuar kësaj edhe gjendjen me covid-19 kemi dorjen se edhe shkollat do të detyrohemi të shndërrojmë në spitale. Dikur politikanët e Kosovës shëroheshin jashtë vendit, kurse tani po shihet se sa është e rëndësishme investimi në shëndetësi dhe rregullimi i saj. Edhe pse shtetet e jashtme investuan në komunën tonë duke ndërtuar një spital modern në qytetin tonë, ne dështuam që të ndërtojmë një kuadër të mirë shëndetësor në këtë spital i cili tani do të na duhej shumë. Ne në spitalin tonë kemi inventarë dhe shtretër por nuk kemi mjek të cilët do të na shërbenin në këtë spital, kjo është një temë mjaft e gjerë. Në këto momente anëtarët e kuvendit nuk din se ka kah të rreshtohen lidhur me spitalin për trajtimin e pacienteve me covid-19, pasi që ta kundërshtosh një gjë të tillë nuk është humane sepse ata pacient duhet të trajtohen diku sepse ndoshta edhe ne do të jemi pacient të shtrirë në këtë spital për tu trajtuar. Në fund tha se është dashur të mendohet shumë herët për shëndetësinë e jo tani kur e kemi të rënduar gjendjen nga pandemia.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-ceku se ku adreson çështje është në stilin e tij të jetë i drejtpërdrejt dhe lakonik në të shprehur bile edhe duke cekur emra e mbiemra. Konkretisht ai vlerësoi se ka marrë mendim nga profesionistët shëndetësor që spitali i qytetit është vështirë ti plotësoj kushtet për tu shndërruar në spital-covid. Andaj duke mos zgjatur gjykon se është çështje politike vendimi që spitali jonë të jetë për trajtimin e pacientëve me covid-19 dhe një vendim i tillë duhet kundërshtuar.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-ceku se politikë e LVV-së është vënia e rregullit në shëndetësi dhe gjitha segmentet tjera të jetës shoqërore. Ai bëri të ditur se qeveritë e kaluara për njëzetë vite me radhë nuk janë marrë me shëndetësinë dhe si pasojë e kësaj sot jemi ku jemi. Andaj ai vlerëson se nuk bëri kurrfarë politike me çështjen e spitalit se duhet apo nuk duhet që ai të shndërrohet në spital-covid.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së-në adresimin e ti para kuvendit, njoftoi se Drejtoria e Shëndetësisë së shpejti do të bëjë thirrjen publik për subvencionin të OJQ-ve që kanë projekte në lëmin e shëndetësisë konform rregullores në fuqi. Tutje shtoi se vendimi për shndërrimin e spitalit të Vushtrrisë në spital-covid është i nivelit qendror pasi shëndetësia sekondare udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Shëndetësisë. Në këtë kontekst ai njoftoi se Drejtoria e Shëndetësisë nuk është konsultuar fare për një vendim të tillë, por nga takimi që kanë pasur me kompetentes shëndetësor është thënë se aktualisht Spitali i Vushtrrisë ka infrastrukturën më të mirë dhe është i përshtatshëm për trajtimin e pacientëve të prekur nga covid-19 dhe kjo sidomos për sa i takon sistemit të oksigjenimiti. Në vazhdim ai vlerësoi se nëse vazhdohet me këtë lakore apo trend të pandemisë që është në rritje jo vetëm spitali i Vushtrrisë por të gjitha spitalet rajonale do të shndërrohen në covid-19. Ai ceku se përtej emocioneve politike të çastit të gjithë duhet të jemi

koshientë dhe pragmatikë sepse gjendja e shëndetësisë publike e sidomos gjendja epidemiologjike është tejet e rënduar dhe në këtë kontekst të gjithë duhet të jemi të bashkuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Nezir Klinaku, për vlerësimin e tij se LVV-ja ndjek politika neveritëse, ceku se LVV-ja është subjekti politik më i madh në nivel vendi dhe komune, dhe nëse dikush kundërshton këto politika atëherë i bie se e kundërshton vullnetin politik të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Tutej ai ngriti çështjen e fermerëve të Komunës së Vushtrrisë për shpërndarjen e qumështit pasi që fermerëve të vegjël dhe të mesëm iu është ndërprerë marrja e qumështi nga qumështoret që operojnë në Republikën e Kosovës por nga sot edhe për fermerët e mëdhenj dhe kjo do të jetë një problematikë në vete. Për këtë ai kërkoi nga Drejtoria e Bujqësisë që të bëjë identifikimin e këtyre fermerëve të cilët po ballafaqohen me këtë problem, dhe të kërkoj nga Ministria e Bujqësisë që këtyre fermerëve tu dilet në ndihmë pasi që kjo e fundi për vitin 2020 i ka rritur fondet për ndihmë fermerëve.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se çështja e rënduar nga pandemia covid-19 nuk duhet politizuar nga askush, dhe shtoi se personalisht ka qenë kundër që spitali i qytetit të shndërrohet në spital-covid, pasi ka pasur mundësi tjera që të shfrytëzohen spitale tjera më në periferi dhe që kanë qenë më të përshtatshëm.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-tha se e mbështetë propozimin për heqje e taksës komunale për personat e verbër, për këtë nevojitet që të hartohet propozim-vendimi nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe i njëjti duhet të aprovohet në kuvend.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-kërkoi që raporti i auditorit për pasqyrat e financiare të Kompanisë “Uniteti” të hiqet nga rendi i ditës pasi që ky material është proceduar me vonesë i cili është mjaft voluminoz dhe si të tillë anëtarët e kuvendit nuk kanë mund ta analizojnë si duhet. Propozoi që të futet në rend të ditës si pikë e veçantë një deklaratë nga anëtarët e kuvendit me të cilin kundërshtohet vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë që spitali i Vushtrrisë të shndërrohet në spital për trajtimin e pandemisë covid-19.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit-kërkoi që të ketë unitet politikë nga të gjitha grupet kuvendar, lidhur me përballimin e pandemisë covid-19 ashtu siç edhe ka pasur një harmoni që nga fillimi i kësaj sëmundje. Tutje shtoi se duke parë që vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë është derivat i rekomandimit të IKSHKP-së, vlerësoi se kundërshtimi i këtij vendimi nuk do të ishte gjëja më e duhur në këto momente. Ai ndan mendimi që duhet të kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë që të shtoj përpjekjet për menaxhimin më të mirë të spitalit të Vushtrrisë në këtë kohë të rënd nga pandemia covid-19. Ne mund të rekomandojmë që të kemi një riorganizim të këtij spitali duke bërë ndryshime në hyrjen e spitalit ashtu që shmangemi kontaktit të pacienteve dhe stafit me objektin e QKMF-së. Pastaj shtoi se si anëtar i kuvendit është kundër një deklaratë ku do të ushtrohej presion Institutit të Shëndetësisë apo ministrisë për menaxhimin e covid-19.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se pajtohet me parafolësin e saj, që nxirret një deklaratë për menaxhimin më të mirë të gjendjen në spitalin e qytetit në aspektin e trajtimit të pacienteve të infektuar me virusin covid-19, furnizimin më të madh me mjete dezinfektuese dhe ofrimin e shpenzimeve për terapi për pacientët, ashtu që familjarët të mos kenë kontakt duke hyrë e dal në spital dhe tani në farmacitë e ndryshme ashtu që do mund të ketë bartje të këtij virusi tek personat tjerë. Një tjetër deklaratë për kundërshtimin e vendimit të ministrisë ajo e cilëson të pa arsyeshme dhe jo logjike kur dihet fakti se tani klinikat janë të mbushura me pacientë gjithandej dhe kemi problem me trajtimin e pacientëve me covid-19.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se në këtë gjendje pandemie të gjitha forcat politike në kuvend duhet të jenë të bashkuara. Shpeshherë ne mendojmë si kundërshtimi i një vendimi të caktuar mund të sjellë përfitime apo simpati tek qytetari ndonjë individ apo grupi politik.

Kundërshtimi i vendimit për shndërrimin e spitalit tonë për trajtimin e pacientëve me covid-19, do të ishte në kundërshtim me motivin për punë të stafit shëndetësor të cilët ballafaqohen me këta pacient të prekur nga ky virus, çfarë do të thoshin profesionistes shëndetësor, sikur ne të themi hiqni pacientë nga spitali dhe qyteti jonë? Ai shtoi se edhe klinika infektive e QKUK-së është në mesin e kampusit Universitar Shëndetësor, por edhe atje trajtohen pacenët me sëmundje të rënda infektive dhe nuk refuzohet asnjë pacientë. Andej është jo etike kërkohet largimi i pacientëve nga spitali jonë kur po shohim çdo ditë përkeqësimin e gjendjes epidemiologjike gjithandej në Kosovë. Ai kërkoi unitet politik dhe anashkalim të luftës politike në këtë gjendej të pandemisë.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-ceku se duke parë që për afro një orë është duke u diskutuar për rendin e ditës dhe çështje kyçe është lufta kundër pandemisë covid-19, ajo e sheh të arsyeshme që kjo çështje të trajtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës apo që për pandeminë të kemi një shqyrtim të veçantë në një mbledhje të jashtëzakonshme. Ajo vlerësoi se të gjithë ne po deklarohemi që mos të bëjmë politikë, por që në realitet të gjithë po bëjnë politikë me çështjen e pandemisë. Për këtë ajo vuri në pah se një nënë me një fëmijë i moshës dy vjeçare dhe me një shtazani të komplikuar, e cila i ka të gjitha simptomat për infeksion me covid-19 i refuzohet kërkesa për të bërë testin, ndërsa ndonjë personi tjetër i veshur me petkun politikë me dy apo tri shenja për covid-19 i bëhet testi, këta persona dalin edhe në televizione dhe publikisht deklarohen se kanë pasur disa simptoma të vogla, kanë bërë kërkesë dhe menjëherë iu është mundësuar që ta bëjnë testin kjo është politizim i skajshëm me pandeminë. Në fund ajo shtroj përsërit nevojën për një mbledhje të jashtëzakonshme për shqyrtimin e gjendje nga pandemia covid-19.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së-tha se në saje të legjislacionit në fuqi përgjegjës për realizimin e testeve është Instituti i Shëndetësisë Publike, dhe institutet rajonale, testet bëhen në saj të vlerësimeve të profesionisteve shëndetësor konform protokolleve shëndetësore të përcaktuara edhe nga OBSH-ja. Ai njoftoi se komuna jonë është ndër pesë komunat e Kosovës që prinë me numrin e realizimit të testeve për covid-19, këto rastet dhe testet janë plotësisht transparente. Nëse ndonjë qytetar nuk ka mundur ta bëjë testin ndjen keqardhje për këtë.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se nuk kërkoi asnjë shpjegim nga Drejtori i Shëndetësisë, por kërkoi mbledhje të jashtëzakonshme për shqyrtimin e gjendjes nga pandemia covid-19. Nuk i beson asnjë veprimi dhe deklarimi të këtij drejtori sepse ajo bëhet sa për të dal në facebook, ndërsa punën e bëjnë profesionistet shëndetësor.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-tha se pandemia covid-19 është një sëmundje globale të cilës nuk i dihet filli dhe mbarimi. Ajo se çfarë mundë të bëjmë ne është një koordinim sa më i mirë për të pasur një luftë të suksesshme në parandalimin e saj. Koordinimi duhet të konsistojë mes nivelit parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor, por koordinimi duhet të jetë edhe mes qeverisë dhe qytetarëve për tu realizuar efekti i parandalimit. Inspektorati komunale, policia dhe qeveria komunale duhet të kenë koordinim më të mirë në parandalimin e këtij virusi, pasi jemi të vetëdijshëm se me lirim e masave do të ketë rritje të numrit të të infektuarave. Qytetaret nuk duhet të bien pre e konspiracioneve se gjoja nuk ka virus dhe se kjo gjë është shpikje e dikujt, pastaj duhet ditur se akoma nuk kemi vaksinë kundër këtij virusi, andaj mbrojtja më e mirë është parandalimi. Në fund ai bërë thirrje për bashkërendim dhe koordinim të të gjithëve duke lënë me një anë ndasitë politike, ti respektojmë masat dhe rekomandimet e përcaktuara nga IKSHPK-ja ashtu që të kemi së më pak të prekur nga ky virus i cili po tregohet shumë i rrezikshëm.

Në vazhdim kuvendi me vota unanime vendosi që heq nga rendi i ditës raportin e auditorit për pasqyrat financiare të Kompanisë “Uniteti”.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 qershor 2020;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020;
3. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të dëgjimeve buxhetore;
4. Shqyrtimi i draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 **(shqyrtimi i parë);**
5. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe raporti i auditimit për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar-qershor) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2020;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
9. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës **(shqyrtimi i dytë);**
10. Shqyrtimi i Draft – Planit të Integritetit 2020 – 2022 **(shqyrtimi i dytë);**
11. Të ndryshme.
12. Shqyrtimi i Draft-rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste - bizneseve në komunën e Vushtrrisë **(shqyrtimi i dytë);**
13. Shqyrtimi i gjendjes së krijuar nga pandemia covid-19 në Komunën e Vushtrrisë;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 qershor 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25 qershor 2020.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020;

3. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të dëgjimeve buxhetore;

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-njoftoi anëtarët e kuvendit për modalitetet e realizimit të dëgjimeve buxhetore për shkak të pandemisë covid-19. Dëgjimet buxhetore këtë vit janë realizuar përmes platformës online, dërgimet të kërkesave në adresën elektronike dhe përmes dërgimit në zyrën pritës të komunës të kërkesave të qytetarëve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar dëgjimeve buxhetore nga viti i kaluar, njoftoi se kërkesat e dala nga këto takime shumica e tyre kanë mbetur vetëm në letër. Konkretisht ai mori shembull se vitin e kaluar është bërë kërkesë për rregullimin e rrugës “Vjena” në Stanoc të Epërm dhe rrugës “Drita” në Maxhunaj dhe asnjëra nga këto kërkesa nuk janë realizuar. Ngjashëm ka ndodhur edhe në fshatin Novolan, ku rruga në lagjen Mehmeti, nuk është ndërtuar edhe pse është evidentuar nevoja dhe kërkesa e atyre banorëve. Në takimin publik vitin e kaluar në fshatin Stanoc i Epërm kanë marrë pjesë banor kryesisht nga po ky fshatë, ndërsa nga fshatrat

përreth ka pasur shumë pak pjesëmarrës, por në këtë kontekst është i çuditshëm fakti se në fshatin Stanoc i Poshtëm gjatë muajve prill, maj dhe qershor 2020 janë asfaltuar 32 rrugë, që ky fshatë është edhe vendlindja e kryetarit të komunës. Andaj pyetjet e tij për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit ishin me sa vijon: *a janë të gjitha këto rrugë të ndërtuara me asfalt rrugë publike? Si është bërë përzgjedhja e tyre dhe cilat kanë qenë kriteret? Sa është kostoja e ndërtimit të këtyre rrugëve dhe a është bërë pagesa dhe nga cili kod ekonomik për kryerjen e këtyre punimeve? Sa është numri i ekonomive familjare që lidhin këto rrugë, sepse nga ajo që ka parë shumica e këtyre rrugëve lidhin vetëm një shtëpi-ekonomi familjare? Cili është kualiteti i punimeve? A janë respektuar procedurat e prokurimit? A janë vendosur këto rrugë të asfaltuar në faqen zyrtare të komunës, nëse jo pse? Po ashtu ai kërkoi sqarime lidhur me atë se nëse në fshatin Stanoc i Epërm janë asfaltuar 32 rrugë, atëherë sa rrugë janë asfaltuar në fshatrat përreth të cilat janë për afërsisht me madhësi sa ky fshatë siç janë fshati Maxhunaj, Dumnicë, Pantinë etj. Ai ceku se i vjen shumë keq që nuk është prezent kryetari i komunës i cili në takim në fshatin Stanoc i Epërm publikisht kishte premtuar se në mes lagjeve Maloku, Bllaca, Haradinaj-Stanoc i Epërm do të ndërtohet një parak, por që ai parak ishte zhvendosur për ndërtim në lagjen Cakaj, në bisedë private me drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit ai ishte përgjigjur se toka ku është planifikuar të ndërtohet ky parak nuk i plotëson kushtet, por një përgjigje e tillë kaq cinike dhe naive është për tu brengosur. Për të gjitha këto ai kërkoi përgjigje me shkrim nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit.*

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarit të kuvendit z. Ymer Haradinaj, sqaroi se nuk është e vërtetë që në fshatin Stanoc i Poshtëm janë shtruar me asfalt 32 rrugë, por janë pesë rrugë në këtë fshatë që janë shtruar, kurse për të gjitha projektet ekzistojnë kontrata të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës. Për ndërtimin e këtyre rrugëve është ngritur një komision i cili ka bërë vlerësimin e rrugëve dhe i ka përzgjedhur ato konform kriterëve duke marrë për bazë edhe numrin e ekonomive familjare. Në fshatin Stanoc i Epërm nga lista e kërkesave të qytetarëve janë asfaltuar 3 rrugë që kanë qenë me prioritet, por natyrisht në listë kanë figuruar rreth 20 rrugë e që të gjitha nuk kanë mundur të ndërtohen për shkak të kufizimeve buxhetore. Ndërsa sa i përket ndërtimit të parkut njoftoi se ka kërkesë me shkrim nga komuniteti që ai parak të ndërtohet aty ku tanë kanë filluar punimet për ndërtimin e tij.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-përsëriti se gjatë muajve prill, maj dhe qershor 2020 në fshatin Stanoc i Poshtëm janë ndërtuar me asfalt 32 rrugë dhe këtë e deklaroi me përgjegjësi të plotë. Për këtë ai vlerësoi se është i gatshëm që nga kuvendi të ngritet një komision nga pozita dhe opozita, ku do të verifikonte deklaratimet se tij se janë shtruar ato rrugë apo jo. Sa i përket ndërrimit të lokacionit të parkut vlerësoi se qytetarët normalisht se dëshirojnë që ta kenë sa më afër parkun, por komuna duhet të vendosë prioritetet aty ku kemi numër më të madh të banorëve. Për këtë vit ai i ka listuar numrin e rrugëve në kërkesë-procesverbal dhe numri i tyre është afër 60 në fshatin Stanoc i Epërm, kjo është bërë me qëllim që mos të manipulohet me qytetarë duke ju thënë se nuk keni parashtruar kërkesë se ajo do të realizohej, kjo është një lojë e ulët politike që është ndjekur vitin e kaluar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit. Lidhur me votimin e buxhetit të destinuar për rrugë vitin e kaluar është i ditur fakti se Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk i kishte votua atë propozim-lisë të rrugëve pasi nuk kishte pasur prioritet të shtrimit të tyre, dhe më tej në kuvend ishte ardhur lista e dëgjimeve buxhetore si tërësi dhe kjo pikërisht e kishte shtruar terrenin për manipulime që janë bërë më vonë nga komuna, sa i përket ndërtimit të rrugëve. Në fund ai kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që ta qetë në votim formimin e komisionit për verifikimin e rrugëve në fshatin Stanoc i Poshtëm.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-përsëriti se nga Drejtoria e Urbanizimit janë kryer pagesat për ndërtimin e pesë rrugëve në fshatin Stanoc i Poshtëm, dhe kjo gjë është publike. Lidhur me

ndërtimin e parkut, vlerësoi se parafolësi i tij duhet të ndihet i privilegjuar që në fshatin e tij po ndërtohet ai parkë. Mashtrim tjetër të cilin anëtar i kuvendit z.Haradinaj iu bënë qytetarëve është që ky njeri i sjellë 60 kërkesa për shtrim të rrugëve, e dihet se këtë vit për shkak të pandemisë janë të planifikuara vetëm 100,000.00 € për ndërtimin e rrugëve në përgjithësi.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit kuvendi me 9 vota "për", 2 vota "kundër" dhe 6 vota "abstenim", nuk e procedoj propozimin e anëtarit të kuvendit z.Ymer Haradinaj për themelimin e komisionit për verifikimin e rrugëve në fshatin Stanoc i Poshtëm.

4. Shqyrtimi i draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021 e Komunës së Vushtrrisë.

2. Diskutimi publik fillon nga data 7 gusht 2020 dhe zgjat deri më 7 shtator 2020.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vushtrrisë që si propozues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin shtator 2020.

5. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe raporti i auditimit për vitin 2019

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-duke u ndaluar në opinionin e auditorit për raportin i cili është cilësuar me titullin si pamodifikuar që pasqyron punën e komunës për vitin 2019, me theksim të çështjeve, ku janë vërejtur disa gjëra në të cilat ka pasur defekte gjatë punës për vitin 2019. Duke ju referuar konkluzioneve të auditorit për pasqyrat financiare në cilat vërehet se ka pasur keq klasifikim të shpenzimeve në mes të kategorive të ndryshme ekonomike për shkak të planifikimit joadekuat, pastaj u ndal në konkluzionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin për të cilat kërkoi sqarime, po ashtu kërkoi sqarime nga drejtori për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se raportin e auditorit e ka titulluar <njëzet të gjeturat të raportit të auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019>. Pastaj shtoi se draft-

raportit i auditorit, kur iu është dorëzuar Komunës së Vushtrrisë ka pasur opinionin e kualifikuar por raporti final është modifikuar dhe vlerësimi final i këtij raporti është: <opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes>, edhe pse nga draft-raporti deri tek raporti final realisht nuk ka pasur mundësi të ndodhin mundësi në pasqyrat financiare, as në performancë, andaj është e pakuptueshme se si auditori ka arritur ta ndryshoj opinionin e vetë. Sidoqoftë opinionin është i keq e për të qenë keq e që mbetet prapë keq auditori ka konstatuar: 1. Keq klasifikim të shpenzimeve në Komunën e Vushtrrisë, 2. Dobësi në menaxhimin e të dhënave në tatimin në pronë, 3. Mos inspektim i 20 % të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës që është obligim ligjor, 4. Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta. 5. Vonesa në liferimin e mallrave. 6. Mangësi në menaxhimin e kontratave. 7. Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore. 8. Dobësi në menaxhimin e subvencioneve. 9. Ndryshime në pozicionet e kontratës jokornizë pa aprovim paraprak të zyrtarit kryesor administrativ. 10. Mungesë të projekteve ekzekutuese. 11. Mangësi në certifikimin e pagesave. 12. Mangësi në procedurat e prokurimit. 13. Vonesa në realizimin e kontratave. 14. Dobësi në vlerësimin e tenderëve. 15. Ndarje jo të drejt në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit. 16. Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive. 17. Rritje të vazhdueshme të llogarive të arktëtueshme ku konstatohet menaxhimi jo efektiv. 18. Vonesa në ekzekutimin e pagesave. 19. Mos kompletimi i njësisë së auditimit të brendshëm e cila rezulton me performancë të ultë të stafit komunal. 20. Rritja e rekomandimeve nga viti në vit p.sh në vitin 2018 kemi pasur 16 rekomandime të auditorit gjeneral, ndërsa në vitin 2019 kemi 19 sosh, kjo i bie se shumica e rekomandimeve të bëra nga auditori nuk janë marrë për bazë nuk janë përmbushur, ndërsa disa prej tyre janë në procedurë, kështu kemi devijim nga punët dhe aktivitetet kryesore komunale dhe performancë të dobët të qeverisjes komunale. Nga të gjitha këto njëzet të gjetura të auditorit shihet se qeveria komunale nga keq menaxhimi ka rrezikuar në masë të madhe buxhetin e komunës dhe taksat e qytetarëve. Në bazë të këtyre konstatimeve mund të konkludohet se qeveria nuk ka arritur defilimin e parashikuar buxhetor dhe kështu kemi pasur shmangje ligjore. Andaj nga ato që u thanë më lartë ai në pika kryesore pyeti: pse bëhen vonesa në liferimin e mallrave pasi që siç dihet nuk ka përfitime nga vonesat e këtij aktivitetit, nëse nuk ka përfitime nga ndonjë zyrtar atëherë përse nuk zbatohen penalltitë ligjore. Pastaj pyeti pse tolerohet keq menaxhimi i kontratave duke rrezikuar edhe implementimin e kontratave, dhe pa i marrë shërbimet shpesh ndodhin devijime në kontinuitet. Tutje pse nuk ka raportet mbi efektin e ndarjeve të subvencioneve, pasi që kuvendi i komunës i ka aprovuar subvencionimin e kamatës, por që realisht nuk ka asnjë informacion për efektin e këtij subvencioni. Pse tolerohet ndryshimi i pozicioneve të kontraktuara madje edhe pa aprovimin e ZKA-së. Si është e mundur të kryhen punët vetëm në bazë të paramsës dhe parallogarisë pa pasur projekt ekzekutues e as zbatues. Si është e mundur që në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike, komuna të kryej pagesat pa i marr mallrat apo shërbimet, kjo është e faktuar me raportin e auditorit, andaj kjo është shumë shqetësuese për faktin se auditimi bazohet në disa mostra dhe rreziku bëhet akoma më i madh kur dihet se kështu vepron në mënyrë sistematike. Nga këto dhe faktet tjera konstatojmë se kemi të bëjmë me një keq qeverisje dhe mungesë të kapaciteteve profesionale, andaj duhet të mendohet për një ristrukturim total të kapaciteteve humane komunale d.m.th stafit komunal, kjo mund të bëhet shpejt përmes procedurave të rekrutimit sepse edhe ashtu kemi vende të lira pune në stafin komunal, ndërsa mjetet financiare në vlerë përmbi 300.000.00 € shkojnë dëm në suficit.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me raportin e auditorit për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2019, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Ai sqaroi se opinionin si raport i pamodifikuar nga ana e auditorit është i mirë për komunën, ndërsa sa i përket

rekomandimeve ceku se nuk është i kënaqur sa i përket zbatimit të tyre. Sa i përket ndryshimit të opinionit nga ana e auditorit njoftoi se edhe viteve të kaluara ka pasur kësi ndryshime por këtë vit ndryshimi është bërë si rezultat i vërejtjeve nga viti i kaluar, që konsistojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve, dobësi në menaxhimin e subvencioneve e gjëra të ngjashme. Lidhur me liferimin e mallrave për disa raste nuk janë zbatuar penalltitë ndërsa për disa tjera janë zbatuar. Për menaxhimin e kontratave kemi pasur vërejtje nga ana e auditorit për shkak të mungesës së stafit profesional në komunë. Sa i përket shpërndarjes së subvencioneve vërejtjet më tepër konsistojnë në kriteret e ndarjes së tyre, por që tani është aprovuar rregullorja komunale e subvencioneve dhe kjo gjë do të rregullohet. Ndryshimi i pozicioneve në kontratë lejohet por që ka ndodhur një lëshim ku është bërë një ndryshim pa aprovimin e zyrtarit kryesor administrativ. Lidhur me pagesën e mallit para se ai të merret, kjo ka ndodhur në një rast të caktuar për shkak të mungesës së hapësirës në rastin e renovimit të muzeut të qytetit e që kemi pasur vërejtje nga auditori i përgjithshëm.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-në adresimin e tij ceku se raporti i auditorit të përgjithshëm është i pakualifikuar e që në aspektin profesional është i mirë për komunën. Tutje ai sqaroi se vërejtjet e auditorit janë bërë, por e vërteta e është se komuna ka vepruar ndikuar në zhvillimin ekonomik, shembull i vije Komuna e Vushtrris ka 190, 000.00 € subvencione, edhe pse është komunë kryesisht bujqësore për kjo është një ndarje jo e drejt, andaj komuna është munduar të bëjë rritje e këtyre subvencioneve por që ka hasur në vështirësi dhe iu janë dhënë vërejtje komunës nga ana e auditorit. Pastaj financimi i bërë nga organizata Islamic Relief është tepër i mirëseardhur e cila ka investuar në shëndetësi për të iu ofruar shërbime shëndetësore primare qytetarëve Vushtrrias, dhe e edhe në këtë aspekt ka pasur vërejtje nga auditori sa i përket kontratave për shërbime të veçanta. Andaj si përfundim theksoj se qeverisja komunale e ka kuptuar drejt se si duhet qeverisur duke marrë për bazë hallin e qytetarëve, dhe duke ndërtuar politika në thithjen e investimeve të huaja për ngritjen e kualitetit të jetesës për qytetarët tanë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se Komuna e Vushtrrisë prinë ndër komunat e para me numrin më të madh të të angazhuarve me kontrata për shërbime të veçanta, edhe përkundër faktit se edhe vitin e kaluar por edhe në këtë vit ka pasur vërejtje serioze nga ana e auditorit të përgjithshëm sa i përket menaxhimit të këtyre kontratave. Pas miratimit të Ligjit për Zyrtarët Publik, kishte pasur shkëputje të këtyre kontratave, por që pas pezullimit të këtij ligji nga ana Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë kishte vazhduar me avazin e vjetër me punësime masive me kontrata për shërbime të veçanta.

6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar-qershor) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi pas votimit me 29 vota "për" 1 votë "abstenim" aprovoi raportin gjashtëmujor (janar-qershor) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2020;

8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-kërkoj sqarime se përse drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve, që nga marrja e mandati nuk është prezent në mbledhjet e kuvendit, për të prezantuar dhe përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, sidomos në respektimin e rregulloreve të qeverisë kundër pandemisë së corona-virusit. Ai vlerësoi se ky njeri në këtë formë po i fyen anëtarët e kuvendit

duke mos treguar fare respekt për ta. Ai shtoi se qytetarët po kanë ankesa ndaj këtij drejtori, për sjellje arrogante i cili është duke u sjellur sikur të ishte policë e jo drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve. Ky drejtor ka për detyrë të menaxhoj stafin e tij sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

9. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës (shqyrtimi i dytë);

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Kodi Komunal i Etikës i Komunës së Vushtrrisë.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij kodi është përcaktimi i rregullave të sjelljes, për zyrtarët komunal sipas standardeve të vendosura me rregullativen komunale, në ushtrimin e detyrës, në përputhje me frymën e etikes profesionale dhe morale të komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Njësia e Personelit, dhe drejtoritë komunale të Komunës së Vushtrrisë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Kodi Komunal i Etikës i Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Draft – Planit të Integritetit 2020 – 2022 (shqyrtimi i dytë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Plani i Integritetit 2020-2022 i Komunës së Vushtrrisë.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është hartimi i infrastrukturës juridike në aspektin e përcaktimit të masave dhe instrumenteve për parandalimin dhe luftimin e praktikave të korrupsionit dhe praktikave tjera joligjore ndaj të cilave janë të ekspozuar zyrtarët komunal.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale të Komunës së Vushtrrisë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani i Integritetit 2020-2022 i Komunës së Vushtrrisë.

11. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Draft-rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste - bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë);

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky version i kësaj rregulloreje është më i kompletuar dhe propozoi që tek neni 7 pika 6 të bëhet ndryshimi dhe plotësimi më sa vijon: Veprimtaritë afariste – bizneset që organizojnë muzikë live, pas pajisjes me leje të veçantë, për veprimtari pas orarit të

punës, duhet të paguajnë shumë prej 50.00 € për orë, por jo më gjatë se në ora 03:00 të mëngjesit, ndërsa ndryshimi duhet të jetë <që këto veprimtari afaristet duhet të obligohen të paguajnë taksë vjetore në vlerë prej 600 €>. Këtë e arsyetoj me faktin se bizneset kanë probleme financiare dhe shuma prej 50 € për orë do të ishte një barrë shumë e rënd dhe do të pamundësonte zhvillimin e veprimtarisë afariste. Pastaj tek neni 13 paragrafi 2 fjalisë restorantet dhe marketet ti shtohet fjalia dhe <si dhe komplekset përcjellëse>.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-ceku se është i mendimit që kjo rregullore të shtyhet aprovimi i saj, me arsyetimin e rrethanave pandemike që po mbretërojnë në të tërë territorin e shtetit, si dhe duke marrë për bazë rregullat dhe instruksionet e IKSHPK-së, për kufizim të orarit të punës të veprimtarive afariste, dhe këto rregulla sigurojnë që e vështirësojnë zbatimin e kësaj rregulloreje. Andaj ai propozoi që aprovimi i këtij dokumenti me rëndësi të shtyhet për ndonjë nga mbledhjet e ardhshme pasi eventualisht deri në dhjetor të këtij viti kur ndoshta do të kemi ndryshim të rrethanave me covid-19.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se është vërtetë që rregulloret e komunave nuk janë duke u zbatuar për shkak se janë nxjerr vendime qeveritare të cilave duhet të gjithë të ju subordinohem. Por megjithatë drejtorja dhe komisioni gjegjësi ka bërë një punë të mirë në hartimin e kësaj draft-rregulloreje, andaj është mirë që ky draft të aprovohet në formën finale dhe zbatimi i saj do të mund të bëhej pas kalimit të rrethanave të pandemisë covid-19.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-në rikapitullimin e debati lidhur me rregulloren në fjalë: konstatoj se tek neni 13, paragrafi 2 duhet të përcaktohet fjalia: restorantet dhe marketet si dhe <veprimtaritë tjera afariste të cilat janë të ngjitura> me pika të shitjes të karburanteve mund të punojnë për të dy sezonet 24 orë - NON STOP duke marrë leje të posaçme nga Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, pas pagesës të taksës vjetore prej 600.00 €.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha si vendosja e taksës prej 50 € për veprimtaritë afariste- bizneset që organizojnë muzikë live, pas orarit të rregullt të punës, kishte për synim vendosjen e një rregulli për një qytet të qetë, dhe kufizim për të rinjtë për frekuentimin e atyre vendeve dhe shmangjen e incidenteve eventuale.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet me mendimin për vendosjen e rregullit për qetësi publike në qytet, por propozimi i tij ishte për taksën prej 50 € e cila është barrë e rëndë për bizneset. Qetësia publike ruhet me nenë të caktuar të rregullores ku thuhet se në afërsi prej 100 metrave të objekteve banuese nuk mund të organizohet muzikë duke prishur rendin dhe qetësin publike të qytetarëve.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-vlerësoi se në këto lokalet ku organizohen ahengje të caktuara, edhe çmimet e shërbimeve nuk janë të njëjta sikurse në lokalet e zakonshme, andaj për këto biznese të cilat në numër mund të jenë katër apo pesë nuk duhet vu në pyetje e tërë rregulloja. Sido që të jetë propozimi ka ardhur nga drejtorja dhe i qëndrojnë asaj se është propozuar por mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit të vendosin me votat e tyre.

Miran Halili, drejtor i DEBPZHR-kërkoi nga anëtarët e kuvendi që kjo rregullore të përkrahet ashtu siç është proceduar në kuvend. Ai argumentoj se kjo taksë nuk i rrezikon bizneset e tilla, pasi kjo aplikohet rrallë dhe në rastet të caktuara, kur organizohen ahengje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ka biznese në Republikën e Kosovës, që veprimtarinë e tyre afaristet e zhvillojnë gjatë orëve të vona të mbrëmjes, siç është organizimi i ahengjeve të caktuara, andaj këto biznese gjatë ditës nuk punojnë fare sepse nuk kanë punë. Aplikimi i taksës prej 50 € në orë do të ishte një barrë tepër e ranë për këtë biznese dhe do ta pamundësonte zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik. Për këtë ai elaboroj një shembull: supozojmë se një lokal i natës që zhvillon një aheng nga ora 21:00, mysafirët fillojnë të grumbullohen nga ora 22:00, ndërsa në ora


kujdes pasi e ardhmja është në duart e tyre. Moshë e re nuk garanton se kjo sëmundje do të kalojë lehtë andaj duhet respektuar rekomandimet e mjekëve. Format e lehta të të prekurve nga sars-covid-2 trajtohen në shtëpi, ndërsa format mesatarisht të rënda dhe të rënda sipas rekomandimeve dhe standardeve të profesionistëve shëndetësor. Për parandalimin e kësaj sëmundje duhet të dëgjohen personat kompetent profesionistë dhe institucionet siç është IKSHPK-ja e jo të dëgjohen diletantët të cilët kanë pasur mjaftë shumë suksese në shpërndarjen e dezinformatave. Në luftimin e kësaj epidemie duhet të jemi gjithë të bashkuar ku secili duhet ta ketë rolin e vetë për japë kontributin për aq sa mundemi dhe sa kemi autorizime. Zbatimi i masave që i ka përcaktuar qeveria në bazë të rekomandimeve të IKSHPK-së duhet të jetë top prioritet. Vendosja e maskave dhe distanca sociale si dhe higjiena personale duhet respektuar me përpikëri, sepse kjo është forma e vetëm tash për tash e parandalimit të kësaj sëmundje. Shembulli më i mirë i respektimit të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publikë janë stafi dhe profesionistët shëndetësor, ku edhe përkundrejt faktit që kanë qenë mjaft të ekspozuar deri më tani në formë zyrtare nga analizat laboratorike janë afektuar vetëm 8 profesionist shëndetësor.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit-tha se duke parë gjendjen e përkeqësuar me covid-19, kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka dal me një komunikatë ku ka njoftuar se namazi i Kurban Bajramit nuk do të falet për shkak të ruajtjes së shëndetit publik. Ai bërë thirrje që gjatë ditës së kësaj feste të anulohen vizitat tek familjarët ashtu që të ruhet shëndeti i njëri tjetrit. Në fund ai të gjithë besimtarëve të besimit Islam iu uroj festën e Kurban Bajramit.

Sylejman Meholli, drejtor i DSHPS-së-tha se kur kishte filluar kjo pandemi i gjithë spektri politik i kishte bërë turr që të merren me menaxhimin e kësaj pandemia, kjo për faktin se një pjesë ka menduar se do të fitoj poena politik, një pjesë ka menduar që është vetë politikë, ndërsa një pjesë tjetër ka deklaruar se virusi është gënjeshtër. Me kalimin e kohës pandemia nuk ka kaluar po ka vazhduar dhe do të vazhdojë akoma dhe kështu që këta persona janë bindur se pandemia nuk është politikë dhe nuk është gënjeshtër! Në mesin e atyre që shquhen që thirren për të mos bërë politikë, ata propozojnë që të diskutohet tema e pandemisë dhe ata largohen duke e lënë në gjysmë diskutimin, kjo tregon të vërtetën. Asnjëherë si Drejtori e Shëndetësisë, nuk do të provojmë ti marrim meritat e profesionistëve shëndetësor por as meritat e heroit të vërtet të pandemisë! Heroi i vërtet i pandemisë sot është qytetari i cili i respekton rekomandimet e profesionistëve shëndetësor lidhur me corona-virusin covid-19. Ata duke respektuar rekomandimet mundësojnë përvetimin e pandemisë dhe menaxhimin e suksesshëm të saj. Pastaj vinë profesionistët shëndetësor të cilët e kanë vu vetën e tyre në dispozicion për ta menaxhuar situatën me virusin corona. Në fund ai uroj të gjithë Komunitetin Mysliman për festën e Kurban Bajramit, duke ju bërë thirrje që të kufizohen vizitat tek njëri tjetri ashtu që të ruhet shëndeti publikë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

